

20080891673

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM**  
**TË LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004) në nenin 2 pas pikës 4, shtohet pika e re 5 si vijon:

"5. "Rajon turistik" është tërësia hapësinore gjeografike dhe funksionale, e cila përfshin disa vende turistike me emërtim të përbashkët, vlerat natyrore dhe vlerat e krijuara turistike të të cilit janë bazë për formimin e ofertës së mëvetësishme turistike, e që paraqet mundësi për formimin e aranzhmaneve turistike nga ana e agjencive turistike;"

Pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 bëhen pika 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Neni 2

Në nenin 3, paragrafi 2, fjalët: "me vëllim të vogël" fshihen.

Paragrafi 3 fshihet.

Paragrafi 4 bëhet paragraf 3.

Neni 3

Në nenin 6 paragrafin 1, fjalët: "Shoqatat turistike sportive" zëvendësohen me fjalët: "sportive", ndërsa pas fjalës "sociale" vendoset lidhëza "dhe" dhe shtohet fjala "arsimore".

Neni 4

Pas nenit 7 shtohet nen i ri 7-a, si vijon:

"Neni 7-a

Personat juridikë dhe fizikë në fushën e turizmit, me qëllim të përparimit të veprimtarive, mund të bashkohen në forma të ndryshme të shoqërimit në pajtim me ligjin."

Neni 5

Në nenin 15, pikat 2, 3, 6 dhe 11 ndryshohen si vijon:

"2) emërtimin "agjenci turistike", agjenci udhëtimi dhe shprehjet e zakonshme siç janë "Tours" dhe "Travel" dhe të ngjashme në firmë mund t'i shfrytëzojnë agjencitë turistike;

3) kur shet pako aranzhmanesh, t'i japë konsumatorit informata të përgjithshme në lidhje me pasaportën dhe vizën që kanë të bëjnë me qytetarët e Republikës së Maqedonisë, dhe veçanërisht në lidhje me kohën e nevojshme për t'i marrë, si dhe për formalitetet shëndetësore të domosdoshme për udhëtim dhe qëndrim;

6) në materialet e botuara promovuese, si dhe në të gjitha dokumentet e punës, dukshëm të theksohet firma dhe selia e agjencisë turistike;

11) për shitjen e aviobiletave, agjencia turistike detyrimisht duhet të ketë të punësuar person me certifikatë IATA;"

Pas pikës 15 shtohet pika e re 16 si vijon:

"16) në vend të dukshëm, në hyrje të objektit turistik ta theksojë llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen."

Neni 6

Në nenin 16 paragrafin 1 pikën 2, fjala "mjetet" zëvendësohet me fjalën "llojet", ndërsa pas fjalës "kategoritë" shtohen fjalët: "mjeteve transportuese".

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2 si vijon:

"Të gjitha kushtet e marrëveshjes doemos duhet t'i bëhen të ditura shfrytëzuesit para se të jepen në formë të shkruar në marrëveshje."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

#### Neni 7

Në nenin 18, në paragrafët 1, 2 dhe 3 fjala "broshurë" zëvendësohet me fjalët: "program udhëtimi".

#### Neni 8

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Kryerësit e veprimtarisë turistike gjatë organizimit të udhëtimeve turistike jashtë vendit me autobusë janë të detyruar të sigurojnë që mjeti i transportit t'i plotësojë kushtet në pajtim me rregullat nga fusha e transportit publik rrugor dhe të ketë kondicionerë, frigorifer ftohës, tualet dhe mikrofon me altoparlant."

#### Neni 9

Në nenin 23, paragrafin 1, fjala "duhet" zëvendësohet me fjalën "detyrohet", ndërsa pas fjalës "siguron" shtohen fjalët: "i jep".

Pas pikës 2 shtohet pika e re 3 si vijon:

"3) opsionet tjera për kontraktimin e policave siguruese për t'u vërtetuar çmimi i anulimit nga ana e shfrytëzuesit ose çmimi për ndihmë në rast të riatdhesimit, fatkeqësisë dhe sëmundjes;"

#### Neni 10

Pas nenit 23 shtohet neni i ri 23-a si vijon:

#### "Neni 23-a

Gjatë shitjes së pako aranzhmaneve, organizatori i udhëtimit është përgjegjës para shfrytëzuesit për kryerje të rregullt të obligimeve që dalin nga marrëveshja, pa marrë parasysh nëse obligimet e tilla duhet të kryhen nga ana e organizatorit apo nga ana e ndonjë ofruesi tjetër të shërbimeve.

Sa i përket dëmit, agjencia turistike nuk përgjigjet për dëm i cili është shkaktuar nga:

- gabimet të cilat paraqiten gjatë zbatimit të marrëveshjes për të cilat është fajtor shfrytëzuesi,
- gabimet të cilat mund t'i përshkruhen personit të tretë, i cili nuk është i lidhur me kryerjen e kontraktuar të shërbimeve dhe nuk janë mundur të parashihen as të mënjanoohen dhe
- gabime të cilat janë rezultat i forcave madhore.

Në rastet nga paragrafi 2 alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, organizatori i udhëtimit do të jetë i detyruar t'i sigurojë ndihmë përkatëse shfrytëzuesit të prekur."

#### Neni 11

Në nenin 27, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Nëse licenca nuk lëshohet në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet se kërkesa ka përgjigje pozitive."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

#### Neni 12

Neni 31 ndryshohet si vijon:

"Për marrje të licencës "A" agjencia turistike detyrimisht duhet t'i plotësojë kushtet vijuese:

- 1) të lidhë marrëveshje vjetore për sigurim me shoqërinë e sigurimeve për përgjegjësi nga kryerja e veprimtarisë në vlerë prej 100.000 eurosh në kundërvlerë të denarit, ose të sigurojë garanci bankare në vlerë prej 100.000 euro;

2) të ketë bonitet pozitiv që dëshmohe me dokument nga Regjistri i Republikës së Maqedonisë për 6 muajt e fundit para dorëzimit të kërkesës, ndërsa për agjencitë e sapothemeluara pas kalimit të 6 muajve nga dita e marrjes së licencës;

3) personi i cili udhëheq me agjenci turistike duhet të posedojë certifikatë për udhëheqje me agjenci turistike;

4) të ketë së paku katër persona të punësuar, nga të cilët dy me dëshmi se e njohin në mënyrë aktive një nga gjuhët botërore dhe

5) të ketë shoqërues turistik gjatë realizimit të çdo udhëtimiti në vend dhe jashtë vendit për së paku 10 persona, si dhe ciceron turistik për vizitë dhe vëzhgim të vendeve turistike."

#### Neni 13

Neni 32 ndryshohet si vijon:

"Për marrjen e licencës "B" agjencia turistike duhet t'i plotësojë kushtet vijuese:

1) të lidhë marrëveshje për sigurim me shoqërinë e sigurimeve për përgjegjësi nga kryerja e veprimtarisë në vlerë prej 50.000 eurosh në kundërvlerë të denarit, ose të sigurojë garanci bankare në vlerë prej 50.000 eurosh;

2) të ketë bonitet pozitiv që dëshmohe me dokument nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për gjashtë muajt e fundit para dorëzimit të kërkesës, ndërsa për agjencitë e sapothemeluara pas kalimit të gjashtë muajve nga dita e marrjes së licencës;

3) personi që udhëheq me agjenci turistike duhet të ketë certifikatë për udhëheqje me agjenci turistike;

4) të ketë së paku dy persona të punësuar, nga të cilët njëri person me dëshmi se në mënyrë aktive njeh një nga gjuhët botërore dhe

5) të ketë shoqërues turistik gjatë realizimit të çdo udhëtimiti në vend dhe jashtë vendit për së paku 10 persona, si dhe ciceron turistik për vizitë dhe vëzhgim të vendeve turistike."

#### Neni 14

Neni 33 ndryshohet si vijon:

"Për marrje të licencës "V" agjencia turistike duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

1) të ketë të punësuar person me dëshmi se në mënyrë aktive njeh një nga gjuhët botërore dhe

2) të ketë shoqërues turistik gjatë realizimit të çdo udhëtimiti në vend dhe jashtë vendit për së paku 10 persona, si dhe ciceron turistik për vizitë dhe vëzhgim të vendeve turistike."

#### Neni 15

Në nenin 33 shtohen tre nene të reja 33-a, 33-b dhe 33-v si vijon:

##### "Neni 33-a

Për t'u pajisur me certifikatë për udhëheqje me agjenci turistike, personi duhet të japë provim profesional para komisionit pyetës.

Komisionin për dhënie të provimit profesional për marrje të certifikatës për udhëheqje me agjenci turistike, e formon institucioni më i lartë arsimor për turizëm dhe hotelieri.

Provimi profesional për marrje të certifikatës për udhëheqje me agjenci turistike jepet sipas programit të caktuar.

Programin për dhënie të provimit profesional për marrje të certifikatës për udhëheqje me agjenci turistike e miraton institucioni i lartë arsimor për turizëm dhe hotelieri pas pëlqimit paraprak të organit të administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e arsimit dhe shkencës.

Programi nga paragrafi 5 i këtij neni shpallet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, personave të cilët kanë të kryer arsim të lartë nga fusha e turizmit dhe hotelerisë, u jepet certifikatë për udhëheqje me agjenci turistike pa e dhënë provimin profesional.

#### Neni 33-b

Harxhimet për dhënie të provimit profesional për marrje të certifikatës për udhëheqje me agjenci turistike i bart kandidati.

Harxhimet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund t'i kompensojnë personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë të interesuar për marrje të licencës.

Shumën e harxhimeve nga paragrafi 1 i këtij neni varësisht nga harxhimet faktike për dhënie të provimit profesional e cakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me drejtorinë shtetërore kompetente për punët nga fusha e turizmit.

#### Neni 33-v

Kandidatit, i cili e ka dhënë provimin profesional, instituti për arsim të lartë i jep certifikatë.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të certifikatës nga paragrafi 1 i këtij neni."

#### Neni 16

Në nenin 36 pika 14 ndryshohet si vijon:

"14) sigurimi i aranzhmanit turistik me garanci në shoqërinë e sigurimeve ose garanci bankare për shkak të kompensimit të harxhimeve të shfrytëzuesit të shërbimeve në rastet vijuese: nëse shërbimet janë lënë pas dore, ndërsa agjencia turistike gjendet në paaftësi pagese ose në falimentim dhe nëse shfrytëzuesi i shërbimeve nuk mund të kthehet për shkaqet e theksuara në këtë paragraf dhe".

#### Neni 17

Në nenin 44 paragrafët 3 dhe 4 ndryshojnë si vijon:

"Legjitimacionin nga paragrafi 1 i këtij neni, e jep personi i autorizuar juridik në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Që të jetë i autorizuar personi juridik nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të ketë të punësuar së paku dy persona me arsimim të lartë. Personin juridik nga paragrafi 3 i këtij neni e autorizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e turizmit".

Pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

"Nëse personi i autorizuar juridik nuk e lëshon legjitimacionin në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni do të konsiderohet se i është përgjigjur pozitivisht kërkesës."

#### Neni 18

Në nenin 45 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Cilësia e shoqëruesit turistik dëshmohet me certifikatë për dhënie të provimit profesional për shoqërues turistik."

#### Neni 19

Pas nenit 45 shtohen tre nene të reja 45-a, 45-b dhe 45-v, si vijojnë:

#### "Neni 45-a

Provimi profesional për shoqërues turistik jepet para komisionit të provimit.

Komisionin e provimit për dhënie të provimit profesional për shoqërues turistik, e formon institucioni i lartë arsimor për turizëm dhe hotelieri.

Provimi profesional për shoqërues turistik jepet sipas programit të caktuar.

Programin për dhënie të provimit profesional për udhëheqës turistik e miraton instituti i lartë arsimor për turizëm dhe hoteleri pas pëlqimit paraprak të organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga fusha e arsimit dhe shkencës.

Programi nga paragrafi 4 i këtij neni shpallet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

#### Neni 45-b

Harxhimet për dhënie të provimit profesional për shoqërues turistik i bart kandidati.

Harxhimet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund t'i kompensojnë personat juridikë dhe fizikë të cilët janë të interesuar për shërbimet e shoqëruesve turistikë.

Lartësinë e harxhimeve nga paragrafi 1 i këtij neni varësisht nga harxhimet faktike për dhënie të provimit profesional e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit.

#### Neni 45-v

Kandidatit i cili e ka dhënë provimin profesional, institucioni i lartë arsimor i jep vërtetim.

Ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi 1 i këtij neni."

#### Neni 20

Në nenin 48, paragrafët 3 dhe 4 ndryshohen si vijojnë:

"Legjitimacionin nga paragrafi 1 i këtij neni, e jep personi i autorizuar juridik në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Që të jetë i autorizuar personi juridik nga paragrafi 3 i këtij neni duhet të ketë të punësuar së paku dy persona me arsimim të lartë. Personin juridik nga paragrafi 3 i këtij neni e autorizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit."

Pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

"Nëse personi i autorizuar juridik nuk e lëshon legjitimacionin në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni do të konsiderohet se i është përgjigjur pozitivisht kërkesës."

#### Neni 21

Pas nenit 48 shtohet nen i ri 48-a si vijon:

#### "Neni 48-a

Personat të cilët punojnë si udhëheqës turistik dhe si shoqërues turistik shënohen në regjistrin e udhëheqësve turistikë dhe shoqëruesve turistikë.

Regjistrin nga paragrafi 1 i këtij neni e mban personi i autorizuar juridik nga neni 44 i këtij ligji.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit."

#### Neni 22

Në nenin 57 paragrafin 1 fjalët: "Programi për propagandë të përgjithshme turistike dhe veprimtari informative në Republikën e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Programi për zhvillim të turizmit".

Paragrafi 2 zëvendësohet me dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, si vijojnë:

"Për shkak të zhvillimit më të shpejtë të turizmit dhe formimit të çmimeve më konkurrenente të aranzhmaneve turistike, do të nxirret Manual për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik, të cilin do ta nxjerrë ministri kompetent për çështjet në sferën e turizmit.

Mjetet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë."

#### Neni 23

Në nenin 61 shtohet pika e re 4, si vijon:

"4) kryen veprimtari si shoqërues turistik pa e dhënë provimin profesional për shoqërues turistik (neni 45-a);".

Pikat 4, 5, 6 dhe 7 bëhen pika 5, 6, 7 dhe 8.

#### Neni 24

Në nenin 63 pikën 2, pas fjalës "ekonomike" vihet presje dhe shtohet fjala "juridike".

#### Neni 25

Në nenin 65 në paragrafin 1, pikat 5 dhe 11 ndryshohen si vijon:

"5) emërtimi "agjenci turistike", agjenci udhëtimi dhe shprehjet e zakonshme siç janë "Tours" dhe "Travel" dhe të ngjashme në firmë nuk i shfrytëzojnë agjencitë turistike (neni 15, paragrafi 1 pika 2);

11) Ushtresit e veprimtarisë turistike gjatë organizimit të udhëtimeve turistike jashtë vendit me autobusë janë të obliguar të sigurojnë që mjeti transportues t'i plotësojë kushtet në pajtim me dispozitat nga fusha e komunikacionit publik rrugor dhe të ketë kondicioner, frigorifer ftohës, tualet dhe mikrofon me altoparlant (neni 19);".

#### Neni 26

Në nenin 66 paragrafin 1, pikat 2, 3 dhe 12 ndryshohen si vijojnë:

"2) kur shet pako aranzhmanesh, nuk i jep konsumatorit informata të përgjithshme në lidhje me pasaportën dhe vizën që kanë të bëjnë me qytetarët e Republikës së Maqedonisë, e veçanërisht në lidhje me kohën që është e nevojshme për t'i marrë, si dhe për formalitetet shëndetësore të domosdoshme për udhëtim dhe qëndrim (neni 15, paragrafi 1, pika 3);

3) në materialet e botuara promovuese si dhe në të gjitha dokumentet e punës, dukshëm nuk theksohet firma dhe selia e agjencisë turistike (neni 15, paragrafi 1, pika 6);

12) angazhon shoqërues turistik, i cili nuk ka së paku përgatitje profesionale të mesme dhe nuk e ka të dhënë provimin profesional (neni 47 dhe neni 45-a);".

Në nenet 8 dhe 9 fjala "broshurë" zëvendësohet me fjalët: "program udhëtimi".

Pas pikës 9, shtohet pika e re 10 si vijon:

"10) në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier nuk e thekson llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen (neni 15, paragrafi 1, pika 10);".

Pikat 10, 11, 12, 13 dhe 14 bëhen pika 11, 12, 13, 14 dhe 15.

#### Neni 27

Titulli i Kreut V. DISPOZITAT NDËSHKIMORE ndryshohet si vijon:

"V. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE" dhe shtohet nen i ri 66-a si vijon:

#### "Neni 66-a

Për kundërvajtjet e konstatuara në nenet 68, 70, 71 dhe 72 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Inspektorati Shtetëror i Tregut (në tekstin e mëtejme: Organi për kundërvajtje).

Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni para organit për kundërvajtje e udhëheq Komisioni vendimmarrës për kundërvajtje (në tekstin e mëtejme: Komisioni për kundërvajtje), i përbërë nga persona juridikë të autorizuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e turizmit.

Inspektori Shtetëror i Tregut është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim para se të dorëzojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në pajtim me dispozitat nga Ligji për kundërvajtje."

## Neni 28

Neni 67 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në vlerë prej 2.500 deri në 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk organizon udhëtim turistik për anëtarët e vet dhe anëtarët e familjes së tyre më të ngushtë përmes agjencive turistike, publikisht i shpall dhe i reklamon udhëtimet turistike (neni 6, paragrafi 1);

2) zyra e punës e agjencisë turistike kryen aktivitete në kundërshtim me licencën që e posedon agjencia turistike (neni 11, paragrafi 2);

3) lidh marrëveshje me ndërmarrje të komunikacionit, mjetet transportuese e të cilave nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregullore nga fusha e qarkullimit rrugor publik (Neni 15, paragrafi 7);

4) lidh marrëveshje dhe ndërmerr aktivitete të tjera pune me subjekte hoteliere juridike të cilat nuk posedojnë licencë dhe kategorizim të objektit (neni 15, paragrafi 1, pika 8);

5) nuk ruan si fshehtësi pune gjithçka që di për shfrytëzuesin e shërbimeve dhe pa pajtimin e tij, përveç në kushtet e rregulluara me ligj, e jep adresën e shfrytëzuesit të shërbimit, vendin dhe kohën e udhëtimit, qëndrimin, çmimin e paguar, si dhe emrin e bashkudhëtarit të tij (neni 15, paragrafi 1, pika 9);

6) nuk u përmbahet kushteve të përcaktuara në marrëveshjet të cilat i lidh me shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personit të tretë si ofrues të shërbimeve (neni 15, paragrafi 1, pika 10);

7) ushtruesit e veprimtarisë turistike, gjatë organizimit të udhëtimeve turistike jashtë vendit me autobus, janë të detyruar të sigurojnë që mjeti transportues t'i plotësojë kushtet në pajtim me dispozitat nga fusha e qarkullimit rrugor publik dhe të ketë kondicionerë, frigorifer ftohës, tualet dhe mikrofon me altoparlant (neni 19);

8) bën rritjen e çmimit të përcaktuar me marrëveshje 20 ditë para ditës së kontraktuar për fillimin e shërbimeve turistike (neni 20);

9) nuk ia kthen shumën e plotë që e ka paguar sipas marrëveshjes, përveç në rastet e parapara në nenin 21, paragrafin 1, pikën 2 të këtij ligji;

10) nuk vepron në bazë të nenit 21, paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji;

11) gjatë realizimit të aranzhmaneve turistike ose të udhëtimit ose qëndrimit jashtë vendit të personave të mitur, nuk u mundëson informata për mbajtje të kontaktit të drejtpërdrejtë me fëmijën ose me personin përgjegjës për ofrim të shërbimit fëmijës në vendin e udhëtimit ose të qëndrimit (neni 23, paragrafi 2);

12) gjatë realizimit të aranzhmanit turistik ose udhëtimit ose qëndrimit jashtë vendit nuk ka dëshmi se posedon licencë (kopje të vërtetuar nga noteri), marrëveshje me objektet e vendqëndrimit jashtë vendit dhe dëshmi për kryerjen e pagesave të vendqëndrimit dhe shërbimeve të tjera përmes institucionit përkatës bankar (neni 24 ) dhe

13) kryen aktivitete në kundërshtim me dispozitat nga nenet 37 dhe 38 të këtij ligji.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, përkrah gjobës për personin juridik do të shqiptohet edhe sanksion ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej 1 deri në 3 vjet.

Gjobë në vlerë prej 500 deri në 800 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës te personi juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 600 eurosh në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, gjobë në vlerë prej 400 eurosh në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes, mund t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni përkrah gjobës, personit përgjegjës te personi juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerje të profesionit , të veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet."

#### Neni 29

Neni 68 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në vlerë prej 3.500 eurosh në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) kryen veprimtari pa u regjistruar në regjistrin e tregut (neni 3, paragrafi 1);
- 2) nuk i plotëson kushtet e përcaktuara minimale teknike (neni 8, paragrafi 1);
- 3) nuk e njofton me formular të posaçëm Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe kryetarin e komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarin e komunës në rajonin e qytetit të Shkupit sipas vendit të selisë së objektit, gjegjësisht sipas vendit ku ofrohen shërbimet turistike së paku tetë ditë para fillimit të kryerjes së veprimtarisë (neni 9, paragrafi 1);
- 4) hapësira e punës shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera (banim dhe prodhim), në kundërshtim me dispozitat nga neni 10, paragrafi 2 i këtij ligji;
- 5) në hyrje të objektit punues nuk e vendos firmën (neni 15, paragrafi 1, pika 1);
- 6) emërtimet "agjenci turistike", "agjenci udhëtimi" dhe shprehjet e zakonshme siç janë "Tours" dhe "Travel" dhe të ngjashme, në firmë nuk i shfrytëzojnë agjencitë turistike (neni 15, paragrafi 1, pika 2);
- 7) me kërkesë të shfrytëzuesit të shërbimeve nuk ia jep informatat se në cilën kategori bën pjesë dhe cilat janë autorizimet e tij, nëse përfaqëson agjenci turistike tjetër (neni 15, paragrafi 1, pika 4);
- 8) nuk lidh marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimit në të cilën do të jenë të përcaktuara qartë kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve (neni 15, paragrafi 1, pika 5);
- 9) në materialet e botuara promovuese, si dhe në të gjitha dokumentet e punës nuk theksohet dukshëm firma dhe selia e agjencisë turistike (neni 15, paragrafi 1, pika 6);
- 10) për shitjen e aviobiletave, agjencia turistike nuk ka të punësuar person me certifikatë të IATA-s (neni 15, paragrafi 1, pika 11);
- 11) në vend të dukshëm në agjencinë turistike nuk e thekson licencën (neni 15, paragrafi 1, pika 12);
- 12) nuk i thekson çmimet e aranzhmaneve turistike dhe shërbimet individuale (neni 15, paragrafi 1, pika 13);
- 13) për çdo shërbim ose aranzhman të shitur nuk jep faturë nga arka fiskale, si dhe vauçer turistik për akomodim dhe shërbime tjera të shfrytëzuesit të shërbimeve (neni 15, paragrafi 1, pika 14);
- 14) nuk i përmbahet shitjes dhe realizimit të marrëveshjes dhe programit të aranzhmanit turistik (neni 15, paragrafi 1, pika 15);
- 15) në vend të dukshëm, në hyrje të objektit turistik, nuk e thekson llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen (neni 15, paragrafi 1, pika 16);
- 16) marrëveshja nuk i përmban elementet e parapara në nenin 16 të këtij ligji;
- 17) vauçeri turistik nuk i përmban elementet e parapara në nenin 17, paragrafi 3 i këtij ligji;
- 18) nuk ka licencë për kryerje të veprimtarisë turistike (neni 25, paragrafi 1);
- 19) nuk e paraqet ndryshimin e përmbajtjes së licencës (neni 29);

20) poseduesi i licencës "A", gjatë kryerjes së punës së tij, nuk i plotëson kushtet nga neni 31 i këtij ligji;

21) poseduesi i licencës "B", gjatë kryerjes së punës së tij, nuk i plotëson kushtet nga neni 32 i këtij ligji;

22) poseduesi i licencës "V", gjatë kryerjes së punës së tij, nuk i plotëson kushtet nga neni 33 i këtij ligji dhe

23) nuk e thekson orarin e punës në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm të objektit dhe nuk i përmbahet orarit të caktuar të punës (neni 56).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, përkrah gjobës për personin juridik do të shqiptohet edhe sanksion ndalim i përkohshëm për kryerje të veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Gjobë në vlerë prej 600 eurosh në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës te personi juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 400 eurosh në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes edhe personit përgjegjës te personi juridik.

Gjobë në vlerë prej 400 eurosh në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për veprimet nga paragrafi 1, pika 1 e këtij neni edhe personit fizik.

Për veprimet nga paragrafi 1 , pika 1 e këtij neni mund t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 300 eurosh në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes edhe personit fizik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni përkrah gjobës, personit përgjegjës te personi juridik do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës nga fusha e turizmit në kohëzgjatje prej 3 deri në 15 ditë."

#### Neni 30

Neni 69 fshihet.

#### Neni 31

Neni 70 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në vlerë prej 1.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të veprimtarisë turistike - tregtar individ për veprimet nga nenet 67 dhe 68 të këtij ligji.

Për veprimet nga neni 67, paragrafi 1 dhe neni 68, paragrafi 1 të këtij ligji, përkrah gjobës do të shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim i përkohshëm për kryerje të veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej së paku tre ditësh deri më së shumti 30 ditë.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 500 eurosh në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes edhe tregtarit individ."

#### Neni 32

Në nenin 71 fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:

"Gjobë në vlerë prej 700 eurosh në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse:".

Në pikën 3 pas fjalëve: "neni 40, paragrafi 2" shtohen fjalët: "dhe neni 45-a, paragrafi 1".

#### Neni 33

Neni 72 ndryshohet si vijon:

"Për veprimet nga neni 68, paragrafi 1, pikat 3, 5, 7, 8, 10, 11 dhe 21 të këtij ligji, inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit mund të shqiptojë gjobë në vend të ngjarjes dhe atë:

- 1) për person juridik 400 euro në kundërvlerë të denarit;
- 2) për person përgjegjës 300 euro në kundërvlerë të denarit dhe
- 3) për person fizik - tregtar individ 200 euro në kundërvlerë të denarit.

Për veprimet nga neni 71, paragrafi 1, pikat 1, 3 dhe 4 të këtij ligji mund të shqiptohet gjobë në vend të ngjarjes në vlerë prej 100 eurosh."

Neni 34

Ushtruesit e veprimtarisë turistike janë të detyruar ta harmonizojnë punën e tyre sipas dispozitave të këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 35

Obligohet Komisioni juridiko-ligjdhënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të vërtetojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".